



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Komiteti për Komunitete**

**Nr. 02-060/01-0022254-1/26 dt. 29.04.2026**

**Mitrovicë**

### **PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete**  
**Seanca e 3-të**

**Koha:** 29.04.2026 ora 14:00

**Vendi:** Salla e Mediave

**Të pranishëm:** Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Fisnik Suma, Armend Begu, Xhyljeta Imeri, Flamur Vojvoda, Gjergj Beka, Jeton Ujkani, Fitim Terziqi, Dzenita Sabani, Sibela Fetahu, Hamide Hyseni dhe Sadete Gashiani

### **Mungoi:**

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Komitetit znj. Hamide Hyseni, e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe bëri të ditur se për këtë mbledhje është propozuar ky:

### **REND DITE:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport financiar për periudhën janar-mars 2026
3. Diskutimi mbi gjendjen dhe nevojat sociale të familjeve në nevojë nga secili komunitet, me fokus në pakot ushqimore dhe format e tjera të ndihmës sociale

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

### **Pika 1**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

## **Pika 2**

U prezantua raporti financiar për periudhën janar-mars 2026, ku u diskutua mbi shpenzimet dhe aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe. Anëtarët e komitetit kërkuar transparencë dhe planifikim më të mirë të buxhetit për aktivitetet që lidhen me komunitetet dhe familjet në nevojë.

## **Pika 3**

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me gjendjen dhe nevojat sociale të familjeve në nevojë nga secili komunitet. Gjatë diskutimit u theksua nevoja për mbështetje më të madhe për familjet me kushte të vështira ekonomike, veçanërisht përmes shpërndarjes së pakove ushqimore dhe formave të tjera të ndihmës sociale.

Anëtarët e komitetit diskutuan për identifikimin e familjeve më në nevojë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat humanitare dhe institucionet komunale për të siguruar mbështetje të vazhdueshme. Gjithashtu u kërkuar që ndihmat të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe pa dallim etnie apo përkatësie komunitare.


Në fund të diskutimit u rekomandua që të hartohet një plan konkret për adresimin e nevojave sociale të komuniteteve dhe të vazhdohet koordinimi me drejtoritë përkatëse komunale dhe organizatat mbështetëse.

Po ashtu, anëtarët e Komitetit për Komunitete sugjeruan që në takimin e radhës të ftohen në takim shëfja e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Mitrovicë, znj. Snezana Nesterovic, si dhe z. Ramadan (Doni) Beshiri, Drejtor për Mirëqenie Sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me qëllim të diskutimit të çështjeve sociale dhe nevojave të komuniteteve.

**Mbledhja përfundoj punimet në ora 14:30 min.**

**Mitrovicë**  
**29.04.2026**

**Procesmbajtës:**  
  
**Afërdita MAXHUNI**

**Kryesuesja e Komitetit**  
  
**Hamide HYSENI**